



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS

PARALAJMRIM PËR VERSHIME

Shteti: **Kosovë**

Regjioni_et): **Pjesa më e madhe e vendit (Rrafshi Kosovës dhe Dukagjinit)**

Kulminacioni i parashikuar i hershëm i ngjarjes: **E diel 03.02. 2018 18:00**

Përqindja e zonave të ndjeshme dhe prekura ndaj rrëshqitjes së tokës:

shumë të lartë 48%, lartë 27%, mesatare 6%

Date e parashikimit: **03-02-2018 – 12:00 UTC**

Deri më: 04 – 02 – 2018 – 23:59

Lëshimi i njoftimit:

03/02/2018, 13:00

Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, në vendin tone që nga orët e hershme të datës 03/02/2018, kanë filluar reshje të dendura të shiut, fillimisht në pjesën përfundimtare të Kosovës (zona malore e Bjeshkëve të Nemura), të cilat kanë shkaktuar formimin e shpejt të rrëqeve në atë zonë dhe shkaktimin e vërshimeve të shpejta.

Gjate ditës së sotme (03/02/2018), pritet intensifikim i reshjeve fillimisht në këtë zonë e pastaj edhe në viset tjera të Kosovës pritet që sasia e reshjeve të jetë e lartë në disa zona dhe deri në mesatarisht e lartë në pjesën veriore dhe lindore të vendit. Intensiteti i reshjeve në disa zona do të jetë rreth 25-40 mm/3h, ku si pasojë pritet edhe ngritje e niveleve nëpër rrjedhat lumore dhe dalje nga shtretërit e tyre në disa segmente lumore si dhe dëme të mundshme.

Piku i niveleve me te larte neper lumenj pritet te arrin sot nga ora 18 te cilët do te vazhdojnë edhe gjate ditës se nesërme , kur edhe pritet qe intensiteti i reshjeve te ulet deri ne ndërprerje. Po ashtu ne zonat e ndjeshme pritet te ketë edhe rrëshqitje te dheut.

Nivelet aktuale ne lumenjtë kryesore te vendit:

1. Drini Bardhe ne Gjonaj – niveli ne ora 12.00 arrin ne : 321 cm
2. Bistrica Pejës ne Gryke – niveli ne ora 12.00 arrin ne: 135 cm
3. Lepenci ne Hanin e Elezit- niveli ne ora 12.00 arrin ne: 162 cm
4. Drini i Bardhe ne Kepuz - niveli ne ora 12.00 arrin ne: 213 cm
5. Sitnica ne Nedakoc – niveli ne ora 12.00 arrin ne: 169 cm
6. Ibri ne Laposaviq- niveli ne ora 12.00 arrin ne: 180 cm
7. Morava Binçes ne Konçul – niveli ne ora 12.00 arrin ne: 294 cm

Ne te gjitha vendmatjet hidrometrike tendenca e nivelit te ujerave është ne ngritje, shih linkun : <http://ihmk-rks.com/t/?page=1,41>, sektori i hidrologjisë , niveli i ujërave ne pellgjet lumore.

Piku i niveleve neper lumenj pritet te arrin sot nga ora 18 te cilët do te vazhdojnë edhe gjate ditës se nesërme kur edhe pritet qe reshjet te ulen ne intensitet deri ne ndërprerje. Po ashtu ne zonat e ndjeshme pritet te ketë edhe rrëshqitje te dheut.



